



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:031729
Datë: 10.09.2024
Numri i dokumentit: 06139552

Pml.nr.545/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. S., nga fshati ..., komuna e L., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” e mbetur në tentativë, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.38/2023, të datës 30.04.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.979/2024, të datës 26.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit S. S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.38/2023, të datës 30.04.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.979/2024, të datës 26.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - dega në Lipjan, P.nr.38/2023, të datës 30.04.2024, i dënuari S. S., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë” e mbetur në tentativë, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, e

nëse nuk mund të realizohet as me detyrim, atëherë gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë në dënim me burgim, konform neni 43, paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro të dënimit me gjobë. Gjithashtu, ndaj të dënuarit është shqiptuar edhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. I dëmtuari S. V., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Është detyruar i dënuari S. S., që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet (20) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.979/2024, e datës 26.07.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit S. S., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- i dënuari S. S., për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim më i butë, siç është dënimi me kusht.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.316/2024, e datës 02.09.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit S. S., të refuzohet si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pas i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

I dënuari S. S., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se është shkelur ligji penal, në kuptim të tejkalimit të kompetencave, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimeve nuk i ka marrë për bazë rrethanat të gjitha rrethanat lehtësuese, e në veçanti pranimin e fajësisë, ndërsa një shkelje e tillë nuk është evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Sipas të dënuarit, pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar, sinqeriteti dhe korrektësia është dashur që nga gjykata e shkallës së parë të vlerësohen si rrethana posaçërisht lehtësuese, në mënyrë që më pastaj, ndaj tij të shqiptohet dënim me kusht, si dënim më i butë se sa dënimi me burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e lartcekura të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje të ligjit penal, nga neni 385,

paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. të KPP-së, siç pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkeluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit S. S., i ka shqiptuar dënime me burgim dhe me gjobë të theksuara më lart, brenda kufijve të parashikuar me ligj për veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkeluar kompetencat ligjore. Kjo për faktin se për veprën penale “Vjedhja e rëndë”, nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së është parashikuar dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.

Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se me rastin e shqiptimit të dënimeve, gjykata në fjalë është bazuar përveç tjerash në nenin 69 dhe në nenin 71, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPRK-së, që i referohen pranimit të fajësisë, ndërsa mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, ndaj të dënuarit S.S., është shqiptuar dënim me burgim nën minimumin e parashikuar me ligj. Në nenin 73, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPRK-së, është parashikuar se “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”, andaj edhe pretendimet e të dënuarit rezultojnë të pabazuara, pasi që pranimi i fajësisë është marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.545/2024, më datë 05.09.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi